



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14 Prill 2022

Nr: 144

V E N D I M

PËR

**ZGJATJEN E AFATIT TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË
SUBJEKTIT ZGJEDHOR “PARTIA DEMOKRATIKE” PËR SHKELJE TË PARASHIKUAR
NË NENIN 91, TË KODIT ZGJEDHOR DHE VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020, TË
KOMISIONIT RREGULLATOR NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE NDAJ
BASHKISË RROGOZHINË**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N :

Referuar nenit 19, pika 1 shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.



Data: 14 Prill 2022

Nr. 144

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” për shkelje të parashikuar në nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Rrogozhinë”

Referuar nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- 1- Komisioneri fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në KQZ.
- 2- Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.
- 3- Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Lidhur me denoncimin e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” ndaj Bashkisë Rrogozhinë, nëpërmjet së cilit pretendohet se, *”Në dispozicion të Partisë Demokratike është vënë lista me emrat e 29 personave, të cilët janë punësuar më datë 25 Janar 2022, në bashkinë Rrogozhinë, për një periudhë 3 (tre) mujore, punësim sezonal i tyre. Punësimi është kryer pas dekretimit të datës së zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022. Këto punësime janë kryer për qëllime të posaçme elektorale në funksion të manipulimit apo ndikimit të vullnetit të zgjedhësve në këto zgjedhje”*, në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor si dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I :

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, për shkelje të parashikuara në nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë

24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Rogozhinë.

2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI

